



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Datë 30.06.2026

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.397/350-22188

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 Për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrërimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, si dhe neneve 44,47,48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUPM në Suharekë lëshon këtë:

AKTVENDIM MBI KUSHTE NDËRTIMORE
(Suharekë)

Ky dokument lëshohet për:

Emri:	Melit Shala, Suharekë	Adresa:	Suharekë
Email:		Kërkesa Bazë:	Kushte Ndërtimore
Tel:			07N.350-22188 datë 13.05.2026

Kushte ndërtimore	Sipas Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë: 28.10.2022
I. Gjendja ekzistuese e lokacionit :	
Zona Kadastrale	Suharekë
Rruga	Rr.“Skënderbeu”
Parcela Kadastrale	00592-6 dhe 00592-7
Sipërfaqja e parcelës kadastrale	887m ² dhe 866m ²
Sipërfaqja e parcelës ndërtimore	887m ² dhe 866m ² totali (1753 m ²)
Numri Referues i certifikatës	Nr. 1648-2026 datë 16.04.2026
Përpjesa e Kopjes së planit kadastral	1:418
Pronësia	Melit Shala-sipas certifikatës Nr.1648-2026
Objekte ekzistuese brenda parcelës kadastrale:	P+0
Objekte ekzistuese përreth lokacionit në diametër 50m’	Gjenden objekte me etazhitet P+1

II. Kushte të Ndërtimit për objektin: NDËRTIM I RI, OBIJEKT I PËRHERSHËM, Objekt afaristo - banesor P+4, KATEGORIA II

III. Lokacion në kuadër të: Hartës Zonale të Komunës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë: 28.10.2022			
IV. Kërkesës i janë bashkangjitur dokumentacionet: Çertifikata e pronës dhe kopja e planit, kopje e dokumentit identifikues, inçizimi i gjendjes faktike në teren nga gjeodeti i licencuar Adriatik Feti me numër të licencës 2 Nr i lëndës 96/2026 datë 08.04.2026, konceptin e projektit si dhe dokumente tjera të nevojshme.			
V. Gjendja e planifikuar duke u bazuar në HZK: Lokacioni në të cilin do të ndërtohet objekti është tokë ndërtimore me destinim sipas HZK-së është sipërfaqe Urbane e Përgjithshme – ZSHP4 (Zonë për shfrytëzim të përzier)			
Përshkrimi në vazhdim i referohet Tabelës 27 Kushtet ndërtimore për zonën për shfrytëzim të përzier ZSHP4 (bazuar në propozimin e referuar nga pala)			
Destinimi	ZSHP-4		
Lloi i strukturës së ndërtimit	Sipërfaqe Urbane e Përgjithshme		
Lloi i ndërtesës	Ndërtesë dyshe		
Kategoria e Objektivit	Kategoria II		
Vija rregulluese	Nga aski i profilit të rrugës "Skënderbeu" në veri – 10.5m'		
Vija ndërtimore nga vija rregulluese	Min 7.0m'		
Etazhiteti	B+P+4, (P+4) e kërkuar nga pala		
Lartësia maksimale e ndërtesës (m')	18m'		
H/L nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5L/1GJ		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me fqinjët	Nuk lejohet		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	Nuk lejohet		
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale për ndërtesat dyshe dhe në varg	2L/1GJ (përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)		
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2.5L/1GJ		
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	Nuk lejohet		
ISHPKZH	max. është e lejuar - 40%		
% e gjelbërimit	50%		
SNP	80%		
ISN	2.0		
Kërkesa minimale për vendparking	2VP/100m ² (min. 10% e parkingjeve të projektohen për përsone me nevoja të veqanta)		
Koeficienti minimal i përqueshmëris termike (U-value(W/m ² K))	Muri 0.5	Kulmi 0.3	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore nga zhurma	08:00-22:00=45db(A)		22:00-08:00=35db(A)
Dendësia maksimale banore/ha	150		
Dendësia maksimale njësi banimi/ha	43		
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m ²)	700		
Thellësia minimale e parcelës kadastrale (m)	35		

Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m)	20
--	----

Te dhëna tjera shitesë rreth kushteve të ndërtimit
Karakter: Objekti i përhershëm me etazhitet P+4
Shfrytëzimi i objektit: Objekti të shfrytëzohet për destinimin e propozuar nga parashtruesi i kërkesës e cila është në përputhje me zonimin e PZHK-së si dhe HZK-së.
Gabariti: Jo më shumë se 40% nga sipërfaqja e parcelës ndërtimore. Vërejtje: këto sipërfaqe mund të zvogëlohen në rast se kërkojnë kushte tjera të lartëcekura – distancat nga fqinjët rruga etj, për ndërtimin e objektit me karakter afaristo-banesor.
Qasja në parcelë: Qasja në parcelë me automjete (për parking) lejohet nga rruga "Skënderbeu" duke i respektuar distancat e qasjeve me rrugët publike sipas UA.
Formësimi arkitektonik dhe estetik: Mënyra e projektimit të bëhet në përputhje me normat teknike të planifikimit duke u bazuar në destinimin e objektit.
Rregullat për zhvillimin e pejsazhit: Gjellrimi përgjatë rrugëve të jetë me bimë-drunjë të cilat kanë aftësi dhe kapacitet për pejsazhe atraktive dhe rregullator të mjedisit.
Numri i hyrjeve: Hyrja kryesore dhe ekonomike.
E drejta e ndriçimit natyror: Mënyra e projektimit të ndriçimit të bëhet në përputhje me normat teknike të planifikimit duke u bazuar në destinimin e objektit. Hapësirat ekonomike pa hapje natyrore duhet ta kenë sistemin e ventilimit.
Vërejtje: Gjatë hartimit të dokumentacionit teknik për objektin, duhet të respektohet forma e parcelës në raport me objektin, qarkullim efikas, me arkitekturë të qëndrueshme duke i dhënë rëndësi ruajtjes së energjisë dhe reduktimi i ndikimeve negative në mjedis.

VI. Kushtet kyçese në infrastrukturë: Kyçja në infrastrukturë të bëhet në rrjetet ekzistuese pas sigurimit të kushteve detale dhe pëlqimeve për kyçe nga: - Leje rrënimi për objektet ekzistuese - KEDS- njësia në Suharekë - Ujësjiellësi dhe kanalizimi – kompania Hidroregjioni Jugor njësia në Suharekë - Mbeturinat - Ekoregjioni në Suharekë - Pëlqim për kyçe në komunikacion – nga inspektori i komunikacionit - Pëlqim për mbrojtje nga zjarri – nga AME (Agjencia e Menagjimit Emergjent) - Koordinatat e vendosjes së objektit sipas kushteve ndërtimore nga gjeodeti i licensuar - Leje mjedisore komunale
--

VII. Kushtet për rregullimin e parcelës ndërtimore (hapësira): Kushtet për rregullimin e parcelës ndërtimore të paraqiten në mënyrë grafike në përpjesën 1:500, 1:250 dhe të jenë pjesë e projektit kryesor ku do të përmbajnë, etazhitetin, gabaritin e objektit, distancat nga fqinjët, vijën ndërtimore, vijën rregullative, hyrjen, pjerrtësitë e pullazit, dimensionet e parcelës, qasjen në rrugë, parkingun, gjelbërimin, rrethojën e parceles.

VIII. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë: - Të dhënat e zyrës projektuese: çertifikatën e biznesit, diplomat e inxhinierëve të lëmive përkatëse, licencat - Deklarata e projektuesit kryesor që projekti është në harmoni me kushtet e dhëna, vendimet dhe rregulloren e komunës si dhe me dispozitat ligjore në fuqi.
--

- Dokumentacioni i hartuar teknik në përpjesë 1:50 të dorëzohet pranë DUPM, në tri kopje origjinale (për palën, dosjen dhe Insp. e ndërtimit) dhe në CD të lidhura (që e mundëson qëndrueshmërinë e tij në kohë) dhe të vulosura nga kompania projektuese e licencuar.
- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës.
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë.
- Përshkrimi teknik me specifikacionin detal të sipërfaqeve bruto dhe neto të objektit (ky dokument është bazë për kalkulimin e sipërfaqes për përshkrim në Lejen e Ndërtimit)
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhës dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute.
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë.
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20.
- Të gjitha fazat e projektit me paramasa dhe parallogaritë, përshkrime, vizatime dhe detale të nevojshme për zbatimin e projektit në teren.
- I gjithë projekti duhet të jetë i nënshkruar nga projektuesit (inxhinier të diplomuar të profesioneve përkatëse) dhe vërtetuar me vulën e zyrës së projektimit.

Shënim me rendësi:

Me këtë aktvendim Shfuqizohet Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore me nr. 537/350-38542 datë 02.09.2025 (pas lëshimit të këtij aktvendimi është bërë ndarja e parcelave kadastrale nr 00592-1 dhe 00592-4 nga të cilat janë krijuar parcela të reja 00592-5, 00592-6, 00592-7 dhe 00592-8. Pala ka paraqitur kërkesë të re për lëshimin e Kushte Ndërtimore për ndërtimin e objektit në parcelat kadastrale nr. 00592-6 dhe 00592-7 sipas gjendjes së re kadastrale dhe projektit të ri.

Vërejtje: Obligohet projektuesi që hartimin e projektit ta bëjë në përputhje me HZK-në, Ligjet e aplikueshme në KS, UA dhe normat në fuqi. Para dorëzimit të projektit një kopje të sjellët në DUPM për kontroll se a është në përputhshmëri me kushtet e dhëna. Në qoftë se projekti kryesor nuk i përmbahet kriterëve të projektimit, informatave të dhëna me këtë dokument dhe kushteve të definuar me HZK dhe normat tjera të definuara për këtë kategori të objekteve, do të kthehet në plotësim apo ndryshim.

IX. Këto kushte vlejnë 1 vjet duke llogaritur nga data e lëshimit të tyre. Vazhdimi i vlefshmërisë së këtyre kushteve mundë të bëhet edhe për një vitë tjetër nëse nuk është ndryshuar pjesa e planit të HZK-së në bazë të të cilit është lëshuar ky dokument.

Vërejtje: Pala duhet që me se voni një muaj para skadimit të afatit të filloi procedurën e marrjes së Lejes së Ndërtimit, në të kundërtën kushtet nuk janë të vlefshme nëse e kalon afatin një vjeçar dhe pala duhet të i nënshtrohet riprocedimit.

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtyre kushteve pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në MMPHI brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes së dokumentit.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.397/350-22188 datë 30.06.2026, Suharekë

Informata i dërgohet: Palës, Inspektoratit të ndërtimit, Dosjes së DUPM-së, Arkivit të Komunës.

Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUÇI

